

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I RREGULLORES, ÇËSHTJEVE JURIDIKE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ DATË ____/____/2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK PËRSA I PËRKET LISTAVE TË PËRFITUESVE, BANORË NË BANESAT INDIVIDUALE, TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM , NJËSIA ADMINISTRATIVE Durrës, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 164, DATË 19.2.2020, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE Durrës, BASHKIA Durrës, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 19.2.2020, “Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim, në Njësine Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar, sipas relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

TË VENDOSË:


1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 6, të VKB nr. 33, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative nr. 4, 5, Rrashbull, Sukth,

Manëz dhe Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë z. Maliq Kulla me numër rendor 1 për arsye se rezultoi e dëmtuar përpara tërmetit të datës 26.11.2019.

2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 9, të VKB nr. 24, datë 03.02.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 3, 4, 6, Sukth dhe Ishëm, Bashkia Durrës”, duke hequr nga kjo listë z. Petro Dedja me numër rendor 25 për arsye ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
3. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 8, të VKB nr. 100, datë 30.03.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 2, 3, 4, 5, 6 dhe Njësitë Administrative Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Manëz, Ishëm, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individual të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë znj. Mereme Gashi me numër rendor 9 për arsye se ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
4. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 7, të VKB nr. 77, datë 10.08.2020, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 2, 4, 5, 6, Sukth, Katund i Ri, Ishëm dhe Manëz, Bashkia Durrës”, duke hequr nga kjo listë z. Danjel Mehmeti me numër rendor 19 për arsye se ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar .

KOMISIONI I RREGULLORES, ÇËSHTJEVE JURIDIKE

	Pozicioni	Emër Mbiemër	Firma
1	Kryetar	Joniada Musaraj	
2	Zv/Kryetar	Arlind Boshku	
3	Sekretar	Dritan Rakipi	
4	Anëtar	Jurgen Zaza	
5	Anëtar	Edlira Devolli	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KOMISIONI I POSAÇËM

RELACION

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK PËRSA I PËRKET LISTAVE TË PËRFITUESVE, BANORË NË BANESAT INDIVIDUALE, TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE Durrës, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 164, DATË 19.2.2020, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE Durrës, BASHKIA Durrës, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”.

Të nderuar këshilltarë,

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” të ndryshuar, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve që rezultojnë përfitues sipas vendimeve të parashikuara përgjatë viteve për sa i përket listës së përfituesve, banorë në banesat individuale të dëmtuara, të cilët kanë përfituar nga procesi i rindërtimit në Zonës e Re për Zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës në zbatim të VKM-së nr. 164, datë 19.02.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në njësinë administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese, i ndryshuar.

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të fillimit të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat, më të rëndësishmet mund të përmendim VKM-në nr.904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e

regullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar.

Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, Zyra e Posaçme e Rindërtimit dhe Komisioni i Posaçëm kanë shqyrtuar dhe vlerësuar aplikimet për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Më specifikisht, detyrat konkrete të komisionit janë të përcaktuara në pikat e poshtëshënuara:

- Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: *Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave për mbanin formacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si mëposhtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuarit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizikosejuridik, subjektisëdrejtëstregtare, ipajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt përfitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.*
- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: *“Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.*
- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: *“Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.”*

Referuar parashikimeve të mësipërme si dhe Raportit me nr. 6841 Prot., datë 05.06.2025, të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit i cili ka verifikuar sërish dokumentacionin e të gjithë aplikantëve të cilët kanë rezultuar përfitues, të miratuar edhe me vendimmarrje nga ana e Këshillit Bashkiak, rezultojnë disa pasaktësi për të cilat lind nevoja të korrigjohen aktet e miratuara për këtë qëllim. Më poshtë ju relatojmë ndryshimet e nevojshme në anekset e vendimeve të këshillit bashkiak përkatës si më poshtë vijon:

- ✓ Për banesat individuale të dëmtuara në Njësine Administrative Nr.4, sipas raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm vendosi:

Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 2, të VKB nr. 155, datë 22.12.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitet Administrative nr. 1,4,5, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” duke hequr nga kjo listë z. Ymer Treshniku me numër rendor 2 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.

- ✓ Për banesat individuale të dëmtuara në Njësine Administrative Ishëm, sipas raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni Posaçëm vendosi:

Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 6, të VKB nr. 33, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative nr. 4, 5, Rrashbull, Sukth, Manëz dhe Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë z. Maliq Kulla me numër rendor 1 për arsye se rezultoi e dëmtuar përpara tërmetit të datës 26.11.2019.

- ✓ Për banesat individuale të dëmtuara në Njësine Administrative Manëz, sipas raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm vendosi:

Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 3, të VKB nr. 24, datë 03.02.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitet Administrative nr. 5, Katund i Ri, Manëz, Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë z. Ednor Gjergji me numër rendor 2 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.

- ✓ Për banesat individuale të dëmtuara në Njësine Administrative Sukth, sipas raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm vendosi:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 9, të VKB nr. 24, datë 03.02.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitet Administrative nr. 1, 3, 4, 6, Sukth dhe Ishëm, Bashkia Durrës”, duke hequr nga kjo listë z. Petro Dedja me numër rendor 25 për arsye ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.

2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 7, të VKB nr. 100, datë 30.03.2023, "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 2, 3, 4, 5, 6 dhe Njësitë Administrative Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Manëz, Ishëm, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individual të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", duke hequr nga kjo listë:

- z. Zaim Methasani me numër rendor 9 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
- z. Algert Shyti me numër rendor 10 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
- znj. Shirete Rusi me numër rendor 11 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
- z. Jashar Gjoka me numër rendor 12 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
- z. Bardhul Broshka me numër rendor 13 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
- znj. Shpresa Shaholli me numër rendor 14 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
- z. Lordjan Topalli me numër rendor 15 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.

3. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 3, të VKB nr. 60, datë 28.02.2023, "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 5, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", duke hequr nga kjo listë z. Ilir Myftari me numër rendor 3 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.

✓ Për banesat individuale të dëmtuara në Njesinë Administrative Katund i Ri, sipas raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm vendosi:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 8, të VKB nr. 100, datë 30.03.2023, "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 2, 3, 4, 5, 6 dhe Njësitë Administrative Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Manëz, Ishëm, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individual të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", duke hequr nga kjo listë:

- znj. Mereme Gashi me numër rendor 9 për arsye se ka ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
 - z. Gjovalin Ndokaj me numër rendor 1 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
 - z. Flori Selimi me numër rendor 2 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
 - znj. Sheje Tabaku me numër rendor 7 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
 - z. Eduart Hushi me numër rendor 8 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 7, të VKB nr. 77, datë 10.08.2020, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 2, 4, 5, 6, Sukth, Katund i Ri, Ishëm dhe Manëz, Bashkia Durrës”, duke hequr nga kjo listë z. Danjel Mehmeti me numër rendor 19 për arsye se ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
3. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 2, të VKB nr. 57, datë 25.06.2024, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë administrative nr. 2, Katund i Ri, Sukth, Manëz dhe Ishëm Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia Natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë z. Gjon Llyci me numër rendor 1 për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.
- ✓ Për banesat individuale të dëmtuara në Njësinë Administrative Rrashbull, sipas raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm vendosi:
1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 6, të VKB nr. 104, datë 30.10.2020, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit/rikonstruksionit në Njësitë Administrative nr. 1,2,4,5,6, Rrashbull, Sukth, Katundi i Ri, Ishëm dhe Manëz, Bashkia Durrës”, duke hequr nga kjo listë z. Nikolin Prenga me numër rendor 8 për arsye se se ka pasur dhe pronë tjetër me funksion banimi në Njësinë Rrashbull.
2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 6, të VKB nr. 100, datë 30.03.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 2, 3, 4, 5, 6 dhe Njësitë Administrative Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Manëz, Ishëm, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individual të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë z. Ramazan Celshima me numër rendor 2, për arsye se nuk ka bërë aplikim për të përfituar.

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian Kallmi

Kryetar



Lorenc Facja

Anëtar



Andri Cerri

Anëtar



Diana Mandia

Anëtare



Klara Agasi

Anëtare



Davide Ndoj

Anëtare



Robert Dervishi

Anëtar



Kadri Gjyli

Anëtar



Muharrem Sula

Anëtar



Edlir Cerri

Anëtar



Eltion Preni

Anëtar



Albert Bukaçi

Anëtar

